

NEWSLETTER

SINDIKATA E PUNONJESVE TE POSTE - TELEKOMIT SHQIPTAR



Firmoset
kontrata
kolektive me
Makhes Albania



Konferencë :
Ku po shkon
Sektori Call
Center?



DREJT BASHKIMIT




Rriten pagat !

Në kompanitë Makhes dhe Teleperformance ka filluar rritja e pagave. Këto rritje pagash për të dy kompanitë vijnë në bazë të kërkesave të vazhdueshme të sindikatës dhe kontratave kolektive të nënshkruara midis SPPTSH dhe kompanive..... fq.2

Kompanitë Albtelecom dhe ONE do të shkojnë drejt një bashkimi me përthithje ku kanë firmosur së fundi edhe zyrtarisht projekt marrëveshjen e bashkimit me përthithje.

Sindikata është njohur me qëllimin e bashkimit të dy kompanive gjatë konsultimeve të mbajtura më datë 25.11.2022 ku është theksuar që synohet rritja e efikasitetit, ulja e kostove, rritja e numrit të klientëve, krijimi i një pozicionimi më të fortë në treg, si dhe rritjen e të ardhurave si rezultat i tyre.

ALBtelecom sh.a. në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, dhe konkretisht atyre që burojnë nga Kodi i Punës, ka njoftuar Sindikatën zyrtarisht me shkresën numër 5993 / dt.2.12.2022 ku ALBtelecom dhe One po vijojnë procedurat ligjore për bashkimin në një njësi të vetme ligjore duke synuar përfundimin e këtij procesi më datë 31 Dhjetor 2022, ku pas bashkimit dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve do të mbajë emrin **ONE Albania sh.a.**



ALBtelecom sh.a dhe ONE Telecommunications sh.a kanë nënshkruar me 28 Tetor 2022, Projekt Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje, dhe si rezultat i procesit të bashkimit, të gjithë punonjësit e ALtelecom sh.a në përputhje me percaktimet e nenit 138 dhe 139 të Kodit të Punës do të transferohen tek shoqëria përthithëse One Telecommunications sh.a; Si pasojë e këtij transferimi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të ALBtelecom në bazë të Kontratës Kolektive dhe Kontratave Individuale të Punës do të kalojnë pa shkoputje në shoqërinë përthithëse. **Kontrata Kolektive e Punës e datës 23.10.2019 nënshkruar ndërmjet ALBtelecom dhe Sindikatës së Post- Telekomit Shqiptar do të vijojë të jetë në fuqi gjatë afatit të vlefshmërisë së saj në shoqërinë përthithëse ONE Albania. Sindikata i fton të gjithë punonjësit e One dhe Albtelecom të anëtarësohen në sindikatë pasi kështu kemi mundësi të jemi një zë më i fortë në realizimin e kërkesave tona.**

KONTRATA KOLEKTIVE ME MAKHES ALBANIA - RRITE PAGAT

SPPTSH ka kënaqësinë të njoftoj të gjithë anëtarët e saj se ka firmosur kontratën kolektive me Makhes Albania, në 19 Tetor 2022. Firmosja e Kontratës kolektive është një garanci më shumë për të gjithë punonjësit dhe vazhdimi i përfitimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive. Gjate negociatave të firmosjes së kontratës kolektive midis SPPTSH dhe Makhes Albania kemi ngritur shqetësimin e pagave.

Kerkesë që është marrë parasysh nga Makhes Albania duke rritur pagën e teknikeve me 3,000 Lekë. SPPTSH po vazhdon negociatat dhe me Albtelecom për të rritur mëtej rrogën e teknikut ku synojmë që paga minimale e teknikut të jetë 50,000 lekë Neto. Gjithashtu i ka bërë kërkesë Albtelecom që të mundësojë paketa më të mira Interneti / IPTV dhe ditën e dielë ditë pushimi.



-Punëdhënësi brenda mundësive do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të mbajtur në punë ose ripozionuar punonjësit që bëjnë pjesë në kategorinë e:

o Punonjësit me statusin e invaliditetit, të vërtetuar me dokumentacionin ligjor përkatës ;
o Punonjës të cilët kanë probleme financiare, sociale ose shëndetsore.
o Punonjës të cilët janë kryefamiljar dhe të vetëm në marrëdhënie pune.
Punonjës të cilët janë në vitin e fundit për të dalë në pension.

Në lidhje me transferimin e punonjësve të shitjes, sindikata është angazhuar si në negociata por edhe duke zhvilluar disa takime informuese online për të informuar punonjësit e shitjes mbi të gjithë procedurën. Gjithashtu nga kompania është kërkuar që të informohen të gjithë punonjësit e shitjes për këtë proces ku është ndërmarr një fushatë informuese mbi pasojat e procesit. Sindikata ka negociuar duke garantuar për punonjësit e interesuar që tju jepesh mundësia për të dalë në reformë ku kanë përfituar rreth 25 punonjës. Kjo ishte një arritje për të gjithë punonjësit e interesuar.

A ka dritë në fund të tunelit ?

Muajt e fundit kanë qënë një periudhë e vështirë për të gjithë, pasi po shkohet drejtë një bashkimi të dy kompanive Albtelecom dhe One. Sindikata është munduar të bëjë më të mirën duke negociuar në çdo hap të proceseve që janë kaluar. Pavarësisht eksperiencës ndërvite nga reformat e kaluara këtë herë detyra ka qënë më e vështirë pasi u përballëm me dy procese paralelisht. Një ishte reforma ndërsa pjesa tjetër ishte transferimi i punonjësve të shitjes te një palë e tretë administruese. Me fillimin e procedurave të pushimit kolektiv nga puna në datë 13.09.2022 i cili parashikonte largimin e 80 punonjësve si rrjedhojë e integritit të dy kompanive mbas blerjes së tyre nga grupi Hungarez 4iG, SPPTSH ngriti një grup pune për negociatat që u mbajtën mes kompanisë dhe sindikatës ku nga ana e sindikatës ne takime morën pjesë Renato Mucaj - Kryetar, Irida Marku, - zv/kryetar, Amarda Hasa - Anëtare Kryesise, Alesia Protopapa - Sekretare Organizative dhe Alket Radovani - Anëtar i Këshillit Kombëtar. Gjate takimeve nga kompania u bë prezantimi i arsyeve se përse ndërmerresh ky shkurtim. Sindikata gjatë takimeve ka kërkuar informacion në lidhje me numrin e 80 punonjësve dhe ka insistuar që ky numër të jetë më i ulët.

Sindikata ka kërkuar që ti kushtohet një rëndësi e veçantë kategorive specifike gjatë aplikimit të reformës siç mund të jenë persona në nevojë financiare me probleme sociale, shëndetsore apo në prag të pensionit. SPPTSH mbas disa takimeve ka arritur një marrëveshje me kompaninë duke konkluduar në:

-Numri i punonjësve të larguar nuk do të jetë më shumë se 70 punonjës.

-Shpërblimi që do të përfitojnë secili nga punonjësit që dalin në reformë, të jetë në përputhje me percaktimet e Kodit të Punës.


-Reduktimi i fuqisë punëtore të kryhet mbi bazën e kriterëve të mëposhtme:

o Pozicioni i punës sipas organikës së re;
o Karriera e punonjësit dhe përshtatja e saj me funksionin që kryen;

o Performanca e punonjësit në rastet e reduktimit të numrit të punonjësve, përveç rastit kur shkurtohet tërësisht vendi i punës;

o Punëdhënësi mund të konsiderojë mundësinë e ofrimit të vendeve vakante për punonjësit e përfshirë në reformë ose familjarët e tyre, në çdo rast në përputhje me pritshmëritë e kërkuara për këto pozicione vakante.

-Përfaqësuesve të Sindikatës, duhet t'i vihen në dispozicion të gjitha të dhënat e nevojshme, procedurat e ndjekura dhe numri final i Punëmarrësve që do të pushohen edhe çdo informacion tjetër i nevojshëm por që nuk tejkalon objektin e kesaj Marrëveshje.



Sindikata po ndjek dhe firmosjen e kontratës kolektive të firma që ka marrë menaxhimin e punonjësve të shitjes. Pavarësisht vështirësive po fillon të duket drita në fund të tunelit. Sindikata ka garantuar fal kontratës kolektive për të gjithë punonjësit shpërblimin për vitin e ri dhe po punon për njësimin e benefiteve në kontratën e re kolektive. Prandaj është shumë e rëndësishme mbështetja e të gjithë punonjësve duke u antarësuar në sindikatë.

KU PO SHKON SEKTORI CALL CENTER ?

19 Tetor 2022 - Fondacioni "Friedrich Ebert" dhe "Olof Palme International Center" organizuan konferencën për sektorin Call Center ku u analizua situata aktuale në sektorin Call Center në Shqipëri dhe u propozuan zgjidhje për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori.

Kryetari SPPTSH z. Renato Muçaj gjatë diskutimeve në Konferencë përveç se bëri një pasqyrë të punës së deri tanishme dhe kontratës kolektive të lidhur me kompaninë Teleperformance identifikojë sfidat dhe perspektivat e këtij sektori.




Aktorë të tjerë të sektorit të pranishëm në konferencë si Kryetarja e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, deputetja znj. Grida Duma dhe zv. Ministri Financave dhe Ekonomisë z. Besart Kadia, Inspektoriati Punës dhe 2 përfaqësues të Sindikatës Gjermane Ver.di z. Ado Wilhelm dhe Florian Haggemiller, që ishin pjesë e kësaj konference u shprehën të gatshëm të bashkëpunonin të gjithë sëbashku dhe të mbështesin nisma që do të ndërrmeren nga sindikata për të përmirësuar kushtet e punës dhe të punonjësve të sektorit dhe përfaqësimin e denjë të interesave të tyre.



Nga SPPTSH morën pjesë në këtë konferencë si përfaqësues të sindikatës por edhe anëtar të saj në kompaninë Teleperformance ku ne përfaqësojmë interesat e punonjësve përmes kontratës kolektive të lidhur midis SPPTSH dhe Teleperformance.

RRITET PAGA

MINIMALE E OPERATOREVE NE TELEPERFORMANCE



Pas takimit me kompaninë Teleperformance, në zbatim të kontratës kolektive për rritjen e pagës minimale është dakortësuar që implementimi i rritjes së pagës të filloj nga muaji Tetor 2022.

Paga minimale orare për operatorët nga 220 lekë/neto do të rritet në 250 lekë/orë neto. Paga për operatorët me vjetërsi do të rritet nga 250 lekë/orë neto në 260-270 lekë/orë neto në varësi të vjetërsisë.

Gjithashtu në bazë të kontratës kolektive ka filluar implementimi në varësi të vjetërsisë në punë, i diteve që i shtohen lejes vjetore ku për

**2-5 vite pune = 1 dite pushim
Mbi 5 vite pune = 2 dite pushim**

Sindikata po vazhdon negociatat për rishikimi e nivelit të pagave për të gjithë punonjësit duke marrë për bazë normen e inflacionit dhe rrethana të tjera. Bashkë për punë të denjë dhe paga më të larta!

Takime me punonjës ne Makhes Albania



Sindikata vazhdon takimet me punonjësit e kompanisë Makhes për të identifikuar kërkesat dhe problematikat e tyre. Këtë herë jemi ndalur në një takim informues me tekniket e rrjeteve të qyteteve Berat, Lushnje dhe Fier. Gjatë takimit punonjësit janë informuar për rëndësinë e organizimit në sindikatë

dhe kanë identifikuar sëbashku problematikat dhe kërkesat që duhet të adresohen punëdhënësit. Ky takim ka shërbyer për të shkëmbyer eksperiencë midis rajoneve dhe për të diskutuar mbi hapat e mëtejshëm që do të ndiqen për kërkesat e punonjësve.

Shpërblimi Fund Vitit

Punonjësit e Albtelecom dhe ONE do të marrin shpërblimin e fundvitit 20,000 Lekë Neto (ose 23,000 Bruto) të parashikuar në kontratën kolektive. Si sindikatë jemi të lumtur që ky shpërblim ju shpërndahe të gjithë punonjësve fal kontratës kolektive.

Sindikata është duke ndjekur në vazhdim dhe shpërblimet e fundvitit për punonjësit Teleperformance & Makhes Albania

Së bashku jemi më të fortë

Si të na bashkohesh?

Plotëso formularin Online!



Skano kodin !

Mos rri po duku!

Mendimi jot vlen shumë për ne!